Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendim nr. 7, datë 01.04.2022 si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH.

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje Formulare nr. 1675, në ngarkim të S. G., me 27 (njëzet e shtatë) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë

të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret"dhe 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

2. Dosje Përpunimi nr. 1673, në ngarkim të M. G., me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

3. Dosje Formulare nr. 117, në ngarkim të N. B., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

4. Dosje Formulare nr. 196, në ngarkim të V. Xh., me 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 51 (pesëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

5. Dosje Formulare nr. 104, në ngarkim të H. M., me 35 (tridhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

6. Dosje Formulare nr. 105, në ngarkim të I. Gj., me 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 39 (tridhjetë e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

7. Dosje Formulare nr. 2642, në ngarkim të H. M., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

8. Dosje Formulare nr. 1340, në ngarkim të M. Sh., me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 21 (njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

9. Dosje Formulare nr. 727, në ngarkim të L. G., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

10. Dosje Formulare nr. 717, në ngarkim të S. T., me 31 (tridhjetë e një) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

11. Dosje Formulare nr. 35, në ngarkim të A. K., me 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 33 (tridhjetë e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

12. Dosje Formulare nr. 5549, në ngarkim të M. M, me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

13. Dosje Fashikullore nr. 702, në ngarkim të A. K., me 14 (katërmbëdhjetë) fletë 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

14. Dosje Formulare nr. 628, në ngarkim të R. M., me 108 (njëqind e tetë) fletë ndër të cilat 25 (njëzet e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

15. Dosje Personale nr. 674, në ngarkim të H. M., me 22 (njëzet e dy) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret Dosja i përket Fondit Operativ.

16. Dosje formulare nr. 3517, në ngarkim të A. V., me 490 (katërqind e nëntëdhjetë) ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

17. Dosje formulare nr. 3517/1, në ngarkim të A. V., me 252 (dyqind e pesëdhjetë e dy) ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

18. Dosje Formulare nr. 1695, në ngarkim të L. G., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

19. Dosje Formulare nr. 5527, në ngarkim të A. P., me 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

20. Dosje Përpunimi nr. 5480, në ngarkim të N. G., me 69 (gjashtëdhjetë e n e nëntë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

21. Dosje Formulare nr. 6092, në ngarkim të P. V., me 209 (dyqind e nëntë) fletë ndër të cilat 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

22. Dosje Formulare nr. 4858, në ngarkim të K. K., me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

23. Dosje Formulare nr. 2091, në ngarkim të A. R., me 21 (njëzet e një) fletë ndër të cilat 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

24. Dosje Personale nr. 10999, në ngarkim të L. D., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

25. Dosje Pune nr. 10999, në ngarkim të L. D., me 49 (dyzet e nëntë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit Sekret". Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1980-1982. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

26. Dosje Formulare nr. 1149, në ngarkim të Xh. D., me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 24 (njëzet e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 9 (nëntë) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

27. Dosje Personale nr. 5377, në ngarkim të H. D., me 49 (dyzet e nëntë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 21 (njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

28. Dosje Formulare nr. 1008, në ngarkim të S. M., me 80 (tetëdhjetë) fletë ndër të cilat 14 (katërmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

29. Dosje Pune nr. 5377, në ngarkim të H. D., me 214 (dyqind e katërmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit Tepër Sekret" dhe 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

30. Dosje Përpunimi nr. 2184, në ngarkim të J. G., me 198 (njëqind e nëntëdhjetë tetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 23 (njëzet e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

31. Dosje Përpunimi nr. 3365, në ngarkim të Z. G., me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

32. Dosje Personale nr. 3580, në ngarkim të G. T., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

33. Dosje Pune nr. 3580, në ngarkim të G. T., me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

34. Dosje Personale nr. 2174, në ngarkim të S. Sh., me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

35. Dosje Pune nr. 2174, në ngarkim të S. Sh., me 195 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega

e Punëve të Brendshme Sarandë.

36. Fashikull, në ngarkim të M. P., me 10 (dhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet në dosje datojnë në vitin 1961. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

37. Dosje Personale nr. 3457, në ngarkim të E. Sh., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ (mikrofilm).

38. Dosje e Problemit të Centralizuar nr.1199, "Zvarraniku", me 20 (njëzet) fletë ndër të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega IV.

39. Dosje Formulare nr. 2907, në ngarkim të V. P., me 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 47 (dyzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

40. Dosje nr. 2183, në ngarkim të N. Z., me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 29 (njëzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH ME VENDIM NR. 8, DATË 15.04.2022

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin 8, datë 15.04.2022 si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje Formulare nr. 12471, në ngarkim të F. M., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 29 (njëzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

2. Dosje Përpunimi nr. 767, në ngarkim të E. Ç., me 109 (njëqind e nëntë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 18 (tetëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.

3. Kartelë Model 2 nr. 2862, në ngarkim të V. B., e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Kartela i përket fondit Dega IV.

4. Dosje e Objektit të Rëndësisë së Veçantë nr. 41, reparti Ballsh, me dy fashikuj fashikulli nr. 1 me 21 (njëzet e një) fletë ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret" dhe fashikulli nr. 2 me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 32 (tridhjetë e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

5. Regjistër agjenture Model 2 nr. 37 datë 28.01.1987 me 180 (njëqind e tetëdhjetë) fletë, fillon me numër rendor 3 dhe mbaron me numër rendor 3172, nga të cilat 23 fletë janë të plotësuara. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Lezhë.

6. Regjistër agjenture Model 2 nr. 16 datë 15.5.1987, me 192 (njëqind e nëntëdhjetë e dy) fletë, fillon me numër rendor 126 dhe mbaron me numër rendor 4882, nga të cilat 39 (tridhjetë e nëntë) fletë janë të plotësuara. Niveli i klasifikimit të regjistrit është "Sekret". Regjistri i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Kukës.

7. Evidencë agjenturale operative e punëtorit operativ, Ekzemplar nr. 2, me 283 (dyqind e tetëdhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Libri i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

8. Evidencë agjenturale operative e punëtorit operativ, Ekzemplar nr. 1, me 283 (dyqind e tetëdhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Libri i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

9. Dosje Personale nr. 3624, në ngarkim të G. G. me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Operativ.

10. Dosje Personale nr. 2908, në ngarkim të A. P., me 48 (dyzet e tetë) fletë, ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

11. Dosje Pune nr. 4332, në ngarkim të T. B., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Gjirokastër.

12. Dosje Formulare nr. 158, në ngarkim të T. B., me 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Fier.

13. Dosje Personale nr. 3149, në ngarkim të D. Gj., me 139 (njëqind e tridhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 54 (pesëdhjetë e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.

14. Dosje Pune nr. 3149, në ngarkim të D. Gj., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 22 (njëzet e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.

15. Dosje nr. 246, "Letër e Drejtorisë së Parë për koordinimin midis Degëve të Punëve të Brendshme për zbulimin e veprimtarisë armiqësore që zhvillohet në repartet riedukimit në burgje dhe në mesin e të internuarve dhe dëbuarve, dërguar Degëve të Punëve të Brendshme" me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

16. Dosje nr. 281, " Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme mbi internim dëbimet dhe Udhëzim i Ministrit mbi internim dëbimet si masë administrative, informacion mbi një rast shkelje ligjshmërie në Degën e Korçës me 14 (katërmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

17. Dosje nr. 247, "Plan pune e konkluzione të Drejtorisë së Parë mbi punën e bërë për zbulimin e goditjen e veprimtarisë armiqësore që është zhvilluar nëpërmjet agjitacionit e propagandës në kundërvënie të pleniumeve të IV dhe V të KQ të PPSH" me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

18. Dosje nr. 245, "Porosi të Drejtorisë së Parë për vlerësimin dhe ndjekjen e të dhënave për tendencë terrori dërguar Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe" me 4 (katër) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

19. Dosje nr. 244, "Porosi të Drejtorisë së Parë për dërgimin e informacioneve mbi veprimtarinë armiqësore në drejtim të elementit antiparti dërguar Degëve të Punëve të Brendshme" me 4 (katër) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

20. Dosje nr. 142, “Raport mbi disa probleme në industrinë e naftës e të gazit sipas detyrave të kongresit të PPSH” me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

21. Dosje nr. 167, “Relacion dërguar udhëheqjes Partisë e Shtetit mbi përfundimin e procesit penal në ngarkim të Xh. S., dhe të implikimeve të personave të tjerë” me 12 (dymbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

22. Dosje nr. 157, “Udhëzim i Ministrit dërguar Degëve të Punëve të Brendshme mbi një shtesë në udhëzimin Nr. 01-629 datë 4.8.1971 mbi internimet e dëbimet si masë administrative” me 3 (tre) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

23. Dosje nr. 242, “Program i përgatitjes profesionale të efektivit të Degës VIII për vitin 1983” me 8 (tetë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

24. Dosje nr. 243, “Plan masash agjenturore - operative të degës VIII me rastin e festave jubilare dhe gjyqin që zhvillohet në Tiranë kundër komplotistëve” me 26 (njëzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

25. Dosje nr. 313, “Kërkesa e ankesa të qytetarëve dërguar Zv. Kryetarit të Këshillit të Ministrave për falje të masës së internim dëbimeve të mbetur” me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 3 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

26. Dosje nr. 127/1, “Informacion për internimet e dëbimet deri në vitin 1975” me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

27. Dosje nr. 10, “Relacion dërguar shokut H. K., mbi gratë e huaja të martuara me qytetarë shqiptare” me 25 (njëzet e pesë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

28. Dosje nr. 67, “Informacion Dërguar Komitetit Qendror të Partisë” mbi masat për spastrimin e brezit të zonës kufitare nga elementët me rrezikshmëri shoqërore dhe njoftim i Komisionit të Internim Dëbimeve mbi internimin e tyre” me 10 (dhjetë) fletë, ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

29. Dosje nr. 252, “Raport propozimi për internime të Degës së Punëve të Brendshme Shkodër drejtuar Drejtorisë së Parë” me 205 (dyqind e pesë) fletë, ndër të cilat 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

30. Dosje nr. 253, “Raport propozimi për internime të Degës së Punëve të Brendshme Shkodër drejtuar Drejtorisë së Parë” me 191 (njëqind e nëntëdhjetë e një) fletë, ndër të cilat 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

31. Dosje nr. 249, “Raport propozimi për internime të Degës së Punëve të Brendshme Berat, Durrës, Elbasan, Fier dhe Gramsh drejtuar Drejtorisë së Parë” me 208 (dyqind e tetë) fletë, ndër të cilat 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

32. Dosje nr. 250, “Korrespondencë midis Degës VIII dhe Degës së Punëve të Brendshme Mirditë, Tropojë, Sarandë, Tepelenë, Krujë, Përmet, Vlorë, Tiranë për internimin e dëbimin e personave të ndryshëm” me 142 (dyqind e dyzet e dy) fletë, ndër të cilat 81 (tetëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

33. Dosje nr. 251, “Raport propozime për internime të Degës së Punëve të Brendshme Pukë, Rrëshen, Tiranë, Tropojë e Vlorë drejtuar Drejtorisë së Parë” me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë, ndër të cilat 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

34. Dosje nr. 248, "Korrespondencë midis Degës VIII-të dhe Degës së Punëve të Brendshme Berat, Durrës, Elbasan, Ersekë, Fier, Gjirokastër, Gramsh për internimin e dëbimin e personave të ndryshëm dhe heqje e ndryshim mase, trajtim kërkesash dhe njoftime për zbatim vendimesh" me 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fletë, ndër të cilat 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

35. Dosje nr. 144, "Përgjithësime mbi një grup armiqësor të goditur në rrethin e Librazhdit dhe Udhëzim mbi vlerësimin e të dhënave për diversion në sektorin e ekonomisë" me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

36. Dosje nr. 124, "Qarkore dërguar Degëve të Punëve të Brendshme dhe informacion dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi disa të meta lidhur me evidentimin e elementit kulak" me 9 (nëntë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

37. Dosje nr. 127/3, "Udhëzim dërguar Degëve të Punëve të Brendshme mbi organizimin e punës operative në drejtim të veprimtarisë armiqësore të kulakëve" me 3 (tre) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

38. Dosje nr. 410, "Propozim për internim dëbime, transferime, zgjatje mase, vendime të komisionit qendror të internim dëbimeve, të familjeve e individëve të internuar" me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë, ndër të cilat 13 (trembëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

39. Dosje nr. 290, "Informacione, relacione të bëra në drejtim të deklasuarve" me 358 (treqind e pesëdhjetë e tetë) fletë, ndër të cilat 104 (njëqind e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

40. Dosje nr. 295, "Korrespodencë midis Degës VIII-të dhe Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe për zbatimin e vendimit nr. 3 datë 17.2.1986 për faljen e gjerë" me 24 (njëzet e katër) fletë, ndër të cilat 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

41. Dosje nr. 293, "Korrespodencë midis Drejtorisë Sigurimeve Shoqërore Shtetërore dhe Degës së VII-të për prekje pensioni të personave të internuar" me 27 (njëzet e shtatë) fletë, ndër të cilat 24 (njëzet e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

42. Dosje nr. 268, "Konkluzione të Drejtorisë së I-rë për zbulimin e autorëve të shkrimeve dhe akteve anonime armiqësore" me 12 (dymbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

43. Dosje nr. 291, "Shkresa përcjellëse të bëra në drejtim të deklasuarve" me 259 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

44. Dosje nr. 292, "Porosi të komisionit të internim dëbimeve për heqjen para kohe të masës së internimit e dëbimit" me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

45. Dosje nr. 289, "Letra të të burgosurve" me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë, ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

46. Dosje nr. 288, "Informacione, relacione të bëra në drejtim të reparteve të riedukimit e burgjet" me 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë, ndër të cilat 37 (tridhjetë e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

47. Dosje nr. 262, "Informacion i Degës së VIII-të mbi studimin dhe vlerësimin e dosjes në kontroll operativ 2B të R. Ll., dhe H. J., me pseudonimin "Emigranti" dërguar zv. Ministrit të Punëve të Brendshme" me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

48. Dosje nr. 261, "Letra të Këshillit të Ministrave për dërgim Komitetit Ekzekutiv, të KP të rretheve, Ministria

e Punëve të Brendshme dërguar Degëve të Punëve të Brendshme për disa probleme për personat e Internuar e Dëbuar" me 7 (shtatë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret".Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

49. Dosje nr. 259, "Korrespondencë midis prokurorisë së përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me disa të internuar" me 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 81 (tetëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH ME VENDIM NR. 9, DATË 15.04.2022

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror"", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 "Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror"", i ndryshuar në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 9, datë 15.04.2022 si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH.

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje nr. 56, "Relacion drejtuar udhëheqjes së Partisë mbi arrestimin dhe deponimet e para të grupit armiqësor B. S.", me 9 (nëntë) fletë, ndër të cilat 1 (një) dokument me 3 (tre) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
2. Dosje Problemit të Centralizuar "Katrani" nr. 906, në ngarkim të N. K., me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë, ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 6 (gjashtë) dokumente me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega IV.
3. Dosje Personale nr. 6616 "Nekiu", në ngarkim të N. K., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) dokumente me 26 (njëzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
4. Dosje Pune nr. 6616 "Nekiu", në ngarkim të N. K., me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 10 (dhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
5. Dosje operative nr. 1, në ngarkim të N. K., me 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë, ndër të cilat 13 (trembëdhjetë) dokumente me 26 (njëzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 24 (njëzet e katër) dokumente me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret".Dosja i përket Fondit Grupet.
6. Dosje operative nr. 2, në ngarkim të N. K., me 202 (dyqind e dy) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të

klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 21 (njëzet e një) dokumente me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Grupet.

7. Dosje operative nr. 3, në ngarkim të N. K., me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 26 (njëzet e gjashtë) dokumente me 65 fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Grupet.

8. Dosje me materiale në ngarkim të N. K., me 6 (gjashtë) fletë, ndër të cilat 3 (tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret" dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Sekret". Dosja i përket Fondit Grupet.

9. Dosje nr. 405, "Korrespodencë ndërmjet Degës VIII, Drejtorisë I-rë dhe Degëve të punëve të Brendshme në rrethe për internim dëbimet", me 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit "Tepër Sekret"dhe 84 (tetëdhjetë e katër) dokumente me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

10. Dosje nr. 407, "Raport propozime për heqjen e masës së internimit dhe për internimin e personave nga rrethet Sarandë, Kukës, Shkodër Burrel, Tiranë ", me 60 (gjashtëdhjetë) fletë, ndër të cilat 20 (njëzet) dokumente me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

11. Dosje nr. 406, "Raport propozime për internim dëbim dhe dokumentet që shoqërojnë ato, korespondencën e Degëve në rrethe me Drejtorinë e Parë", me 120 (njëqind e njëzet) fletë, ndër të cilat 44 (dyzet e katër) dokumente me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

12. Dosje nr. 400, "Korespodencë ndërmjet Degës VIII dhe Degëve të Punëve të Brendshme në Korçë, Krujë, Kukës për internim dëbimet", me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë, ndër të cilat 102 (njëqind e dy) dokumente me 123 (njëqind e njëzet e tre) fletë. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

VEPRIMTARI

TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIUDHËN MARS–PRILL 2022

KUVENDI MIRARTON STRUKTURËN E POSAÇME NË AUTORITET, PËR TË ZHDUKURIT NË DIKTATURË

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancën e 17 marsit strukturën e re të Autoritetit, ku përfshihet njësia e posaçme për të zhdukurit në diktaturë.

Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", u miratua me 85 vota pro, asnjë kundër dhe 21 abstenim.

Me dispozita të veçanta në ligjin organik 45/2015, i ndryshuar, dhe në zbatim të ligjit nr. 9802, datë 13/092007 "Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të OKB-së "Për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me forcë", Autoritetit iu dhanë kompetenca të shtuara dhe rol parësor:

-në bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit;

-në marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime, ku legjislatori parashikon se rregullat e bashkëpunimit përcaktohen me marrëveshje dy apo shumëpalëshe, të lidhura për këtë qëllim midis palëve dhe sjell në vëmendje se, "Autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".

Për të realizuar këto detyra themelore, të shtuara në ligjin organik 45/2015 me ligjin nr.114/2020, dt.29.07.2020, i botuar në Fletoren Zyrtare me 28 gusht dhe hyrë në fuqi në shtator 2020, deri më sot është punuar gjerësisht me dokumentacion, kuadrin ligjor dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, (me Policinë e Shtetit), si dhe me tryeza teknike ndërinstitucionale për koordinimin e përgjegjësive.

Proceset e punës që Autoritetit i janë caktuar me ligj zhvillohen gjerësisht në terren, dhe për to nevojiten burime njerëzore shtesë, të shoqëruara me kosto financiare, (deri tani janë mbuluar nga projektet e Autoritetit me partnerë).

Drejtoria e sapomiratuar për Marrëdhëniet Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, me pesë punonjës, do të ketë si fushë veprimi bashkëpunimin ndërinstitucional për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve dhe marrjen e masave për ruajtjen e vendvarrimeve, duke plotësuar çdo komunikim institucional të Autoritetit me autoritetet përgjegjëse dhe ndjekjen e projekteve të dedikuara, duke krijuar kësisoj një tablo të qartë të të gjithë veprimtarisë për të pagjeturit, përfshirë edhe aktorët e tjerë në këto procese, sa delikate, aq edhe humane.

DIPLOMACIA DHE KULTURA

Më 28 mars 2022, Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula mori pjesë në aktivitetin me temë: "Pluralizmi fetar dhe sfidat politike në një vend kufitar; mes së shkuarës dhe së ardhmes", pjesë e ciklit "Diplomacia dhe kultura", organizuar nga Qendra për Hapje dhe Dialog në Kryeministri.I ftuar, ambasadori i Selisë së Shenjtë, Shkëlqesia e Tij, imzot Luigi Bonazzi.

Tema për të cilën foli imzot Bonazzi ishte "Pluralizmi fetar dhe sfidat politike në një vend kufitar; mes së shkuarës dhe së ardhmes". Në takim ishin të pranishëm edhe znj. Nevila Nika, pedagoge në Universitetin Evropian të Tiranës; znj. Aljula Jubani, Drejtore e Institutit të Studimeve Evropiane në Universitetin e Tiranës dhe z. Klodian Bulku, kyetar i Komitetit Shtetëror për Kultet. Po ashtu edhe studentë nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Europian i Tiranës, të cilët diskutuan mbi çështje të ndryshme të trajtuara në prezantimin e z. Bonazzi.

Arqipeshkvi Bonazzi se do të kërkonte nga Papa Françesku ofrimin e një burse për të studiuar në arkivat e Vatikanit për një prej studentëve të interesuar, një mundësi kjo e veçantë studimi, e cila u krijua falë takimeve në COD.

PËRKUJTOHET DEMONSTRATA ANTIKOMUNISTE E 1990 NË KAVAJË

Më 25 mars 2022, Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula dhe Anëtari z. Simon Mirakaj, morën pjesë në aktivitetin përkujtimor në nderim të demonstratës antikomuniste të 1990 në qytetin e Kavajës morën pjesë në ceremoninë përkujtimore të zhvilluar në stadiumin "Besa" të këtij qyteti.

Thirrjet "Liri Demokraci", "Poshtë diktatura", "Poshtë dinastia", gjatë ndeshjes "Besa""Partizani" në stadiumin e qytetit, zbuluan se propaganda komuniste ishte fund e krye mashtrim.Protesta u pasua me arrestime masive dhe hetuesi intensive ndaj të rinjve protestues.

PËRKUJTOHET MESHA E PASHKËVE E MBAJTUR NË KAMPIN E TEPELENËS

Më 2 prill, në ish-kampin e internimit në Tepelenë, u përkujtua 70-vjetori i Meshës së Pashkëve të prillit 1952, të kremtuar nga pesë priftërinj katolikë, Dom Nikollë Mazreku, Padër Jak Gardini, Padër Viktor Volaj, Padër Zef Gilaj dhe Padër Ferdinand Paci.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, anëtari, z. Simon Mirakaj dhe të mbijetuar të kampit e trashëgimtarë të tyre, si dhe besimtarë të ftuar nga Administratura Apostolike e Shqipërisë së Jugut morën pjesë në cere-

moninë përkujtimore në kamp dhe kremtimin e Udhës së Kryqit, për të nderuar kujtimin e atyre që e humbën jetën në kampin me tela me gjemba të Tepelenës.

Imzot Giovanni Peragine, Imzot Angelo Massafra dhe Imzot Arjan Dodaj, mes dhjetëra të pranishmëve në kamp, shkuan Udhën e Kryqit, duke risjellë përmes humanizmit, fuqinë e shpresës për më mirë, që udhëhoqi Meshën e Pashkëve të Prillit 1952, lehtësuese për të gjithë të ndëshkuarit e kampit, pavarësisht besimit.

PREZANTOHEN VIDEOT E SHKURTRA MBI PORTRETET E SË MAJTËS SË PËRNDJEKUR

AIDSSH dhe FES u bënë bashkë në një projekt serioz dhe sfidues, për të ndriçuar këtë aspekt të historisë sonë të afërt. Dhjetë intelektualë të mirënjohur, filozofë, gazetarë, mendimtarë e përkthyes, shkrimtarë e njohës shumë të mirë të dinamikave në vend e jashtë tij, u trajtuan me profesionalizëm dhe në dritën e dokumenteve historike.

4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare profileve të përzgjedhura, duke riskicuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX.

Sejfulla Malëshova, Kostandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Luarasi, Petro Marko, Xhavid Qesja, Isuf Keçi, Zef Mala e të tjerë janë personalitete që u frymëzuan nga aspiratat për drejtësi shoqërore dhe punuan për ta ngritur e formësuar të majtën në vend, si e majtë europiane.

"E MAJTA" – NJË RRUGËTIM NË HISTORI! MENDIMI POLITIK I SË MAJTËS SHQIPTARE

Rrugëtim historik i pesë figurave të majta të sjella nëpërmjet videove prezantuese! Reflektim për të ardhmen duke qymtuar të shkuarën! Histori të cilat na ushqejnë me informacion mbi debatet politike aktuale, normat, vlerat dhe orientimet.

"Demokracia kërkon demokratë" është motoja e Friedrich Ebert dhe Petro Marko, Sejfulla Maleshova, Isuf Luzaj,

Skender Luarasi dhe Musine Kokalari ishin disa prej tyre. Janë histori njerëzore me qasje të ndryshme politike por me një ëndërr: Një Shqipëri më të mirë!

Jetet e tyre patën drama, sakrifica, ëndrrat e tyre nuk arritën dot të bëhen realitet në kohët që jetuan, por një gjë është e sigurt, ata i dhanë ngjyra një realiteti të errët të sistemit komunist.

Këto figura politike të historisë sonë, të cilat nuk janë të vetmet, por vetëm disa prej tyre, na ofrojnë një arsenal konceptual të së majtës duke na orientuar në arsyetimin e saj dhe duke na ankoruar në retorikën e saj.

Diskursi i tyre politik shërben si një lente përmes së cilës mund të lexojmë historinë dhe të shohim botën dje, por dhe sot e nesër. Këto figura ndihmojnë në ndërtimin e hartës së shoqerisë së majtë e cila plotësohet në çdo kohë dhe historia i tregon.

Gjatë aktivitetit të mbajtur në mjediset e Kinema "Millennium", dhe pas prezantimit të videove të cilat përshkruajnë jetët politike të pesë figurave tona, një panel prej katër të ftuarish, Znj. Stine Klapper, Drejtoreshë e Fondacionit "Friedrich Ebert", Z. Edon Qesari, historian dhe bashkautor i studimit, "E majta" – Mendimi politik/Profile Biografike, Znj. Linda Kokalari, Familjare e Musine Kokalarit dhe Z. Ditmir Bushati, politikan me nje identitet të theksuar ideologjik, trajtuan jetët e personaliteteve tona, duke reflektuar mbi ideologjitë e kohës. Petro Marko, Sejfulla Malëshova, Isuf Luzaj, Skënder Luarasi dhe Musine Kokalari, kanë shumë për të na mësuar dhe mbeten një model inspirues për të rinjtë dhe jo vetëm.

TRAJTIMI I SË KALUARËS ME OBJEKTIVITET, TRANSPARENCË DHE DREJTËSI, PËR REHABILITIMIN, INTEGRIMIN DHE DËMSHPËRBLIMIN E PLOTË TË SHTRESËS SË TË PËRNDJEKURVE POLITIKË ËSHTË DOMOSDOSHMËRI.

Historia na mëson se nëse tragjeditë harrohen janë të destinuara të rikthehen.

E kaluara e familjes Plaka, në përballjen e saj me diktaturën dëshmon dinjitetin me të cilin anëtarët e saj sfiduan dhunën, terrorin dhe persekutimet, duke kaluar një kalvar të madh vuajtjesh, me 11 burra të dënuar politikisht me pushkatim, burgim, punë të detyruar dhe internim.

Në vlerësim të qëndresës heroike dhe të integritetit njerëzor, duke rrezatuar një shembull frymëzues të rezistencës pata sot nderin të vlerësoja tre anëtarë të kësaj familje atdhetare, Shaban Plaka, Hanko Plaka dhe Behije Plaka.

Nder përjetë të gjithë luftëtarëve, disidentëve dhe ish-të përndjekurve politikë të Shqipërisë!

NJOHJA NXIT STUDIMIN

"Armiku i Popullit" në gjenetikën e diktaturës

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

Studimi u përgatit nga Jozef Radi, në kuadër të konferencës ndërkombetare shkencore "Fytyra e "Armikut" të popullit" të AIDSSH, në bashkëpunim me ASA, ISKPK, IIPP dhe Muzeu Historik Kombëtar.

S'do t'i dhuroja asnjë grimë kohë së shkuarës, sikur ajo të mos të më kishte vjedhur të ardhmen time, dhe mos të kërcënonte jo vetëm të ardhmen time por edhe shumë te tjerëve. S'do të harxhoja një sekondë të vetme, për kohën e mbetur pas, pos kujtimeve

të bukura, sikur ajo kohë e mos të na gjuante me paftyrësinë e krimeve të pandëshkuara, jo vetëm ndaj meje, po ndaj gjithë atyre që vuajtën padrejtësisht një diktaturë të gjatë e të pashoqe, po edhe gjithë gjeneratave që vijnë mbas nesh, e që e shohin me dyshim dhe mjegull të ardhmen e tyre.

Për fat të keq, ende ndjehem i dënuar nga e shkuara. Vetëm në moshën 70 vjeçare, më takon ta kapërcej gjysmën e jetës të mbetur peng në çengelin e diktaturës dhe "Armikut të Popullit". Kjo e shkuar tragjike e një pjese të mirë të popullit shqiptar ka rënduar me këtë nofkë barbare e të padrejtë. Shumkujt ajo i është trupëzuar qysh fëmijë çka s'i lejon ata të harrojnë asgjë. Prandaj, e ndjej për detyrë, që çdo gjurmë e asaj së shkuare më gjithë tragjiken e saj, të mbrrijë një të nesërme në muzeumet e munguara të kujtesës, të jetojë si e vërtetë në sytë e çdo individi.

Identiteti dhe profile i grave të dënuara politike në periudhën komuniste (1946-1979)

Punimi u përgatit nga Fiona Todhri dhe Eris Dhamo, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH, ASA, ISKPK, "Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1944-1990".

- Sot, shoqëria jonë ndihet në borxh ndaj figurave historike të dënuara politikisht gjatë periudhës komuniste, për njohjen dhe përcjelljen brez pas brezi të vlerave shumëdimensionale të tyre përmes fakteve, dëshmive dhe përvojave të të gjitha grave e burrave që vuajtën dhe u privuan pa të drejtë jo vetëm nga liria, por

dhe nga ëndrra e tyre për një vend më të mirë dhe të lirë. Me këtë fokus ky studim përshkruan në mënyrë të detajuar fakte rreth figurës dhe qëndresës së gruas intelektuale gjatë sistemit të mëparshëm komunist.

Studimi i referohet periudhës historike 1946-1979, e cila përkon me përfundimin e L2B dhe fillimin e rendit të ri politik në vend. Kusht i përzgjedhjes së figurave të marra në studim janë gratë e dënuara politike.

Referuar analizës së proces-verbaleve gjyqësore që janë mbajtur për këto gra të dënuara politike, letërkëmbimeve, mbrojtjes, deponimeve, si dhe akuzave të bëra gjatë gjykimit ose/dhe mungesës së gjykimit, dorëshkrimeve, punimeve dhe mbrojtjes së disertacioneve, rezulton shprehja e forcës së mendimit, qëndresës,

idealeve dhe temperamente të hekurta, pavarësisht vuajtjeve apo përdhosjes se dinjitetit që i bëhej nga pushteti i asaj periudhe. Analizimi dhe interpretimi na prezanton dhe disa karakteristika, përshkrimi i të cilave qoftë me fjalë me kuptim të drejtpërdrejt apo të figurshëm (me anë të epiteteve, metaforave etj.), nuk do të mjaftonte për të ndërtuar një kuadër të plotë të figurës së tyre, duke u ndalur sidomos në vlerësimin e vetëdijes intelektuale,integritetin, si dhe frymën idealiste që i karakterizonte.

Rezulton se gratë e marra në studim hodhën themelet e para dhe tentuan krijimin e një shoqërie demokratike dhe të lirë.

Dëshmia e Lekë Tasit mbi të atin dhe xhaxhanë, Koço dhe Akile Tasi

Babai im, Koço Tasi, u dënua si nacionalist. Kishte studiuar në itali për jurisprudencë, aty nga viti 1914. Mori pjesë në parlamentin e parë Shqiptarë, si deputetë. Për rolin që luajti në politikën shqipëtare në vitet 1920, e arrestuan mu në qendër të Tiranës dhe e dënuan me burgim të përjetshëm.

Dëshmia e Lekë Tasit për babain dhe xhaxhain e tij është përfshirë në botimin "Zhdukur nga diktatura – Dëshmojnë familjarët.

AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë